

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"S'ka celular, merrni laptop"/ GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatojeni, ose ndiqni rrugët ligjore!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/s039ka-celular-merrni-laptop-gjkkko-nuk-terhiqet-nga-r-regullorja-censurue-i586648
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 10:09:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 10:25:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	95374c8e2894fe78987997c4b6649bbcf19541a4baa0b0f401e42859decd4209
TEKSTI	918f48de29c4668470e1ea646f21064edfe9b80e2d1a7bd2443263ec2d0294d7
PAMJA	be3c514fb6890a1464f762c2c121d22ca6bd3972712a3007fe83b156b357d697

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1d7c7e1e0afaf9f6b44fa1895670c46c85133680388e2a0b80dd07a263261247
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1d7c7e1e0afaf9f6b44fa1895670c46c85133680388e2a0b80dd07a263261247>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie "Dyfisho supermarrjen tende", Ibrahimaj: Mbi 1.700 biznese kane shprehur interes./20 ne trajtim VIDEO/ Tensione ne proteste, qytetaret sulmojne me veze e shishe uji po fundit

"S'ka celular, merrni laptop"/ GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatojeni, ose ndiqni rrugët ligjore!



17 Shtator 2026, 12:25Kronika TEMA

GJKKO nuk e ka në plan të tërhiqet nga rregullorja e re censuruese, që prek jo vetëm mediat por edhe avokatët, të cilët kishin kërkuar rishikimin e saj. Në një përgjigje drejtuar Dhomës së Avokatisë, GJKKO iu thotë avokatëve, të cilët deri më tani kanë bojkotuar gjyqet, që të zbatojnë rregulloren ose në të kundërt të ndjekin rrugët ligjore.

Në letër GJKKO u thotë avokatëve që kontestimi i rregullores nuk duhet të shërbejë për bojkot gjyqesh. Sipas GJKKO, celulari i është ndaluar edhe prokurorëve, gazetarëve, gjyqtarëve.

Në një përgjigje drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, GJKKO argumenton se rregullat e reja të sigurisë janë të ligjshme, të nevojshme dhe proporcionale, duke i lidhur ato me natyrën e çështjeve që shqyrton, nga korrupsioni i nivelit të lartë te krimi i organizuar.

Gjykata kundërshton gjithashtu pretendimin se telefoni celular duhet të konsiderohet "studio e lëvizshme" e avokatit, ndërsa bën dallimin me kompjuterin portativ, përdorimi i të cilit mund të lejohet për shënime dhe konsultimin e dokumenteve gjatë seancave.

OSTRATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR KANCELARI

Nr. 3283/prot.

Tiranë, më 16.09.2026

Lënda: Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 228 prot., datë 01.09.2026 me lëndë: "Kërkesë për rishikimin e dispozitave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar".

**Z. Maksim HAXHIA
KRYETAR I
DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË**

TIRANË

I nderuar z. Haxhia,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 228 prot., datë 01.09.2026¹, përmes së cilës shprehet mosrënia dakord lidhur me zbatimin e disa dispozitave të Rregullores së Brendshme "Për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar".

të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO)“ (në vijim Rregullorja), dhe në veçanti me kërkesën për rishikimin e nenit 76 të saj lidhur me mbajtjen dhe përdorimin e telefonave celularë në sallën e gjykimit, GJKKO-ja çmon të nevojshme të sqarojë dhe parashtrojë sa më poshtë vijon:

1. Fillimisht GJKKO-ja gjen me vend të theksojë se vlerëson rëndësinë thelbësore të rolit të avokatit në garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të procesit të rregullt ligjor, si dhe e konsideron dialogun institucional me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë pjesë të rëndësishme të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë. Avokacia është një komponent i domosdoshëm i administrimit të drejtësisë dhe ushtrimi i lirë, i pavarur dhe efektiv i funksionit të mbrojtjes përbën një garanci që GJKKO-ja ka detyrimin ta respektojë dhe ta sigurojë.
2. Sikurse është e njohur edhe nga përvoja profesionale e shumë anëtarëve të Dhomës së Avokatisë që ushtrojnë veprimtarinë pranë GJKKO-së, natyra e posaçme e juridiksionit të saj dhe karakteristikat e çështjeve që shqyrtohen kërkojnë, njëkohësisht, standarde të shtuara të sigurisë. Në sallat e gjykimit administrohen

¹ Protokoluar nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 3099 prot., datë 02.09.2026.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Sekuestrohen dy celularë të paligjshëm në burgje, procedohen 8 persona

11:30 Kronika

"Nuk më janë vënë në dispozicion të gjitha fashikujt" - Shtyhet gjyqi i themelit për Ilir Metën, ja kur do të mbahet
seanca e radhës

11:00 Kronika

VIDEO/ Transportonte me makinën "Porsche" 13 lingota floriri kontrabandë, arrestohet 30-vjeçari

10:40 Kronika



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.